

OKSIMETRI ME PULS

Çfarë duhet të dini mbi përdorimin e pajisjes për matjen e saturimit të oksigjenit dhe pulsit (rrahjeve të zemrës)

Vlerat normale për një njeri të shëndetshëm: **95+%**

Oksimetri me puls

- Këto pajisje të vogla mund të përdoren për të monitoruar nivelin e oksigjenit në gjak
- Pajisja mat nivelin e saturimit të oksigjenit në gjak dhe rrahjet e zemrës.
- Nivelet e ulëta të oksigjenit mund të shkaktojnë një kusht shëndetësor të njohur si 'hipoksi', që mund të sjell vështirësi në frymëmarrje dhe deri në humbje të ndërgjegjes, dëmtime të trurit apo edhe vdekje.



!!!Kujdes: lexoni udhëzimet shoqëruese për saktësinë e matësit tuaj !!!

Oksimetri me puls



Pajisja vendoset në gishtin e pacientit dhe është e përbërë nga një sensor dhe një monitor i vogël që paraqet vlerat e matura.

LED

Drita infra e kuqe dhe e kuqe ndriçojnë përmes gishtit

Absorbimi i gjatësive valore të dritës

- Mënyra se si absorbohen spektrat përkatës në sensor mund të përdoren për të përllogaritur nivelin e oksigjenit në gjak.
- Hemoglobina e oksigjenuar në gjak përthith më tepër dritë infra të kuqe dhe lejon të kalojë shumë dritë të kuqe.



Kujdes! Thonjtë e gjatë mund të ndikojnë në matjen e SpO₂

Ku mund të përdoret?

Oksimetri përdoret zakonisht në pavionet e urgjencës ose në spitale për të monitoruar shenjat jetësore të pacientit.

Krijuar nga ekipi i
Heda
ASISTENTJA E SHËNETIT TUAJ